

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, zhvilluan një takim informues dhe sensibilizues me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Eleminimin e Dhunës ndaj Grave.

Qëllimi i këtij takimi ishte informimi dhe sensibilizimi i studentëve mbi ndikimin e dhunës ndaj gruas, theksimi i rëndësisë së respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe ofrimi i informacionit mbi mundësitë ligjore të mbrojtjes. Takimi synoi të nxisë reflektimin dhe angazhimin e të rinjve në parandalimin e dhunës, si dhe promovimin e një ambienti të sigurt për të gjithë.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Përmet dhe Gjirokastrë, si dhe studentë të universitetit.

